



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:099310
Datë: 20.01.2023
Numri i dokumentit: 03880762

C.nr.2478/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A. B., G. G., R. D., F. K. dhe M. M. të cilët sipas autorizimit i përfaqëson V. S. avokat në Lipjan, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës – Qendra e Mjekësisë Familjare me seli në Prishtinë, përfaqësuar me autorizim nga L. S. – T., me objekt kontesti, kompensimin e pagës së 13-të, vlera e objektit të kontestit 9,935.64, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 17.01.2023, me prani të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, me datë 17.01.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET tërësisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve A. B., G. G., R. D., F. K. dhe M. M. dhe DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës – Qendra e Mjekësisë Familjare me seli në Prishtinë, që paditësve t’ua paguaj shumat si në vijim:

- Paditëses së parë A. B., në emër pagës së trembëdhjetë për vitin 2018,2019 dhe 2020, t’ia paguaj shumën prej 1498.62€, në emër të kamatës së akumuluar për pagën e trembëdhjetë për këto tre vite nga rënia në vonesë e secilës page veç e veç e deri me datën 24.10.2022 në shumën prej 338.68€, në emër të kontributit pensional në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës për pagën trembëdhjetë për këto tre vite shumën prej 165.60€, dhe në emër të tatimit të mbajtur në burim në Administratën Tatimore të Kosovës për pagën trembëdhjetë për këto tre vite shumën prej 92.52€.

- Paditëses së dyte G. G., në emër pagës së trembëdhjetë për vitin 2018,2019 dhe 2020, t'ia paguaj shumën prej 1482.42€, në emër të kamatës së akumuluar për pagën e trembëdhjetë për këto tre vite nga rënia në vonesë e secilës page veç e veç e deri me datën 24.10.2022 në shumën prej 334.98€, në emër të kontributit pensional në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës për pagën trembëdhjetë për këto tre vite shumën prej 165.60€, dhe në emër të tatimit të mbajtur në burim në Administratën Tatimore të Kosovës për pagën trembëdhjetë për këto tre vite shumën prej 90.69€.

- Paditësit të trete R. D., në emër pagës së trembëdhjetë për vitin 2018,2019 dhe 2020, t'ia paguaj shumën prej 1255.68€, në emër të kamatës së akumuluar për pagën e trembëdhjetë për këto tre vite nga rënia në vonesë e secilës page veç e veç e deri me datën 24.10.2022 në shumën prej 283.78€, në emër të kontributit pensional në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës për pagën trembëdhjetë për këto tre vite shumën prej 139.14€, dhe në emër të tatimit të mbajtur në burim në Administratën Tatimore të Kosovës për pagën trembëdhjetë për këto tre vite shumën prej 91.92€.

- Paditëses së katërt F. K., në emër pagës së trembëdhjetë për vitin 2018,2019 dhe 2020, t'ia paguaj shumën prej 1493.16€, në emër të kamatës së akumuluar për pagën e trembëdhjetë për këto tre vite nga rënia në vonesë e secilës page veç e veç e deri me datën 24.10.2022 në shumën prej 337.44€, në emër të kontributit pensional në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës për pagën trembëdhjetë për këto tre vite shumën prej 166.86€, dhe në emër të tatimit të mbajtur në burim në Administratën Tatimore të Kosovës për pagën trembëdhjetë për këto tre vite shumën prej 91.92€.

- Paditëses së peste M. M., në emër pagës së trembëdhjetë për vitin 2018,2019 dhe 2020, t'ia paguaj shumën prej 1384.08€, në emër të kamatës së akumuluar për pagën e trembëdhjetë për këto tre vite nga rënia në vonesë e secilës page veç e veç e deri me datën 24.10.2022 në shumën prej 312.79€, në emër të kontributit pensional në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës për pagën trembëdhjetë për këto tre vite shumën prej

154.08€, dhe në emër të tatimit të mbajtur në burim në Administratën Tatimore të Kosovës për pagën trembëdhjetë për këto tre vite shumë prej 79.77€.

II. DETYROHET e paditura që secilit prej paditëseve, secilën prej shumave të gjykuara sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë në pikat (1), (2), (3), (4) dhe (5), t'ua paguaj me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data 25.10.2022 e deri në pagesën definitive, në afat prej shtatë (7) ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi.

IV. DETYROHET e paditura që paditësve, t'ua paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 1,443.20 €, në afat prej shtatë (7) ditësh nga data e pranimi të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësit A. B., G. G., R. D., F. K. dhe M. M., përmes të autorizuarit të tyre, me datë 24.05.2021, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kanë paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Prishtinës – Qendra e Mjekësisë Familjare me seli në Prishtinë, me objekt kontesti, kompensimin e pagës së 13-të, vlera e objektit të kontestit 9,935.64.

Në padi si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështje, palët paditëse përmes të autorizuarit të tyre, kanë theksuar se mbeten pranë padisë dhe kërkesëpadisë së parashtruar. Tutje ka theksuar se me kontratën kolektive sektoriale të datës 11.06.2018 të lidhur ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës të Sindikatës së Shëndetësisë me nenin 17 par.2 është paraparë mundësia e kushtëzuar e kompensimit të pagës së trembëdhjetë për punëtorët shëndetësorë. Kjo mundësi e kushtëzuar është e njëjtë sikur lidhja e kontratës me kusht, e përcaktuar më nenin 59 të LMD-së. Kushti sipas kësaj kontrate kolektive sektoriale është se punëtorët shëndetësorë kanë të drejtë në kompensimin e pagës së trembëdhjetë për çdo vit kalendarik sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit. Në këtë rast i bie se në rast se punëdhënësi në këtë rast e paditura ka mundësi buxhetore, pra, ka tepriçë të buxhetit atëherë e drejta e paditësve për

kompensimin e pagës së trembëdhjetë automatikisht shndërrohet në detyrim të të paditurës për kompensimin e pagave të trembëdhjeta.

Sipas Raportit të Auditimit për të paditurën për vitin 2018, 2019 dhe 2020, raport ky i Zyrës Kombëtare të Auditimit, i cili është publik, rezulton se e paditura në këto 3 vite kalendarike ka pasur tepricë të buxhetit, në të gjitha kategoritë ekonomike, por tepricë të buxhetit ka pasur edhe nga të hyrat vetanake. Po që se e paditura kishte me pasur vullnet për tua paguar paditësve pagat e trembëdhjeta në këtë tepricë të buxhetit gjatë këtyre 3 viteve i ka pasur të gjitha mundësitë financiare të paditësve t'ia paguajë pagat e trembëdhjeta, mirëpo faktikisht e paditura nuk ka pasur vullnet që ta bëjë një gjë të tillë dhe deri më tani për kundër mundësive financiare që i ka pasur paditësve nuk ia ka paguar pagën e trembëdhjetë për vitin 2018, 2019 dhe 2020.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike dhe bazës juridike të kërkesëpadisë gjykatës i propozojmë që ta bëjë administrimin e provave që janë në shkresat e lëndës si dhe ta bëjë nxjerrjen e provës me ekspert financiar i cili ekspert do të kishte detyrë që së pari të konstatojë se për vitin 2018, 2019 dhe 2020 e paditura a ka pasur mundësi buxhetore-suficit të buxhetit, në rast se ka pasur atëherë ta llogaritë se me këtë tepricë të buxhetit a ka pasur mundësi financiare që për secilin nga këto 3 vite tua paguajë paditësve pagën e trembëdhjetë, sipas KKS-së, dhe nëse ka pasur mundësi që ta bëjë një pagesë të tillë si dhe kane propozuar ekspertizë financiar.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësve, përmes parashtresës me shkrim, të dorëzuar në këtë gjykatë me datë 17.01.2023, ka precizuar kërkesat e parashtruara për secilin paditës veç e veç, precizim i cili është lejuar nga gjykata.

Në fjalën përfundimtare, të cilën e kanë dorëzuar me shkrim dhe të njëjtën e kanë këmbyer me të paditurën, kanë theksuar se nga provat e administruara është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë si dhe lartësia e saj. Ka shtuar se e paditura me asnjë provë nuk ka arritur të dëshmojë të kundërtën në lidhje me bazën e kërkesëpadisë apo lartësisë së saj. Më tej, ka theksuar se baza juridike e kërkesëpadisë lidhur me shpërblimin jubilar

mbështetet në nenin 17 paragrafi 3, pika 3.1, 3.2 dhe 3.3 të Kontratës Kolektive Sektoriale, pasi që paditësit kanë arritur vitin jubilar. Ndërsa, sa ai përket kërkesës për kompensimin e pagës së trembëdhjetë bazohet në nenin 17 paragrafi 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale sipas së cilës parashihet “Punëmarrësi ka të drejtë në kompensimin e pagës së trembëdhjetë për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”. Ka shtuar se lidhur me kushtëzimin e mundësive buxhetore të të paditurës për kompensimin e pagës së trembëdhjetë është vërtetuar përmes konstatimeve të ekspertit financiar, ku i njëjti ka konstatuar se e paditura në buxhetin e saj ka pasur mjete financiare për kompensime të tilla, andaj e drejta e kushtëzuar e paditësve e përcaktuar sipas nenit 17 paragrafi 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale, paraqet detyrim për të paditurën për kompensimin e pagave të trembëdhjeta për vitet 2018, 2019 dhe 2020. Lidhur me kërkesën sa i përket kamatës, kanë theksuar se kamata e akumuluar e kërkuar gjen mbështetje në nenin 382 të LMD-së dhe në pikën XVII të Mendimit juridik për kamatën që kanë të bëjnë me paga dhe kërkesa të tjera nga marrëdhënia e punës, duhet të llogaritet nga arritja e secilës kërkesë veç e veç. Ndërsa kamata vetëm ndaj borxhit kryesor llogaritet nga data e përfundimit të ekspertizës. Në fund, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve të aprovoj në tërësi.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në bazë të Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës, dhe atë: për përpilimin e padisë shumen prej 312€, për dy seanca të mbajtura nga 405.60 shumen prej 811.20€, për ekspertize financiare shumen prej 300€ si dhe në emër të takës gjyqësore shumen prej 20€ e në totalin e përgjithshme shumen prej 1,443.20 €.

E paditura në përgjigje në padi si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se e kundërshton kërkesëpadinë e paditësve. Ka shtuar se Kontrata Kolektive është nënshkruar nga niveli qëndror dhe të njëjtit duhet të mbulojnë kompensimet të cilat rrjedhin nga kjo kontratë.

Në fjalën përfundimtare, ka theksuar se këto lloje kompensimesh nuk janë të parapara me Ligjin e Punës andaj Komuna e Prishtinës në skemën e saj buxhetore nuk ka

paraparë linjë të posaçme për këto lloj kompensimesh. Për më tepër kontrata kolektive të cilës i referohet paditësi nuk e obligon Komunën e Prishtinës që të bëjë pagesën e pagës së trembëdhjetë, prandaj si e tillë kërkesa duhet të refuzohet, e paditura pretendimet e paditësit se Komuna e Prishtinës ka pasur suficit të buxhetit në vitet paraprake dhe si rezultat i kësaj e paditura ka qenë e detyruar të bëjë pagesën e pagave të trembëdhjeta nuk qëndrojmë sepse paraja publike i nënshtrohet ligjit për menxhimin e financave publike e ne bazë të këtij ligji dhe ligjit për ndarje buxhetore nuk kane parapanë asnjë linjë për kompensimin e këtyre kërkesave. Duke u bazuar në ato që u thanë i propozojmë gjykatës që kërkesën e paditësve ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar provat si në vijim: Kontratën e punës për kohë të pacaktuar pwr A. B. e datës 01.01.2013; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar, pwr G. G., e datës 01.01.2013; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar, pwr R. D. e datës 01.01.2013; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar, pwr F. K. e datës 01.01.2013; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar, pwr M. K. e datës 01.01.2013; ekspertiza financiare e datës 24.10.2022 e punuar nga eksperti financiar Sh. S.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit Nr. 06/L-003 për Procedurën Kontestimore (tutje: LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku. Mbi këtë bazë, gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia e paditëseve është e bazuar.

Gjykata me leximin e kontratave të punës, për secilin paditës veç e veç, ka vërtetuar faktin se paditësit janë të punësuar pranë të paditurës, përkatësisht janë të punësuar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare me seli në Prishtinë, e cila qendër është nën menaxhimin e Komunës së Prishtinës, Drejtorisë për Shëndetësi.

Gjykata me leximin e listave të pagës për secilën paditëse veç e veç, ka vërtetuar faktin se paditësit kanë realizuar pagë mujore, për punën e kryer pranë të paditurës.

Nga leximi i ekspertizës financiare të hartuar nga Sh. S., ekspert financiar, me datë 24.10.2022, në përputhje me detyrat e përshkruara nga gjykata, në aktvendimin me të cilin është aprovuar marrja e provës përmes ekspertizës financiare, ka bërë llogaritjen matematikore përkatëse lidhur me kërkesat e parashtruar nga ana e paditësve, duke përcaktuar lartësinë e secilës kërkesës në shumën konkrete, dhe atë: për paditësen e parë A. B. në emër pagës së trembëdhjetë për vitin 2018,2019 dhe 2020 shumen, t'ia paguaj shumën prej 1498.62€, në emër të kamatës së akumuluar për pagën e trembëdhjetë për këto tre vite nga rënia në vonesë e secilës page veç e veç e deri me datën 24.10.2022 në shumën prej 338.68€, në emër të kontributit pensional në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës për pagën trembëdhjetë për këto tre vite shumën prej 165.60€, dhe në emër të tatimit të mbajtur në birim në Administratën Tatimore të Kosovës për pagën trembëdhjetë për këto tre vite shumën prej 92.52€.; për paditësen e dytë G. G., në emër pagës së trembëdhjetë për vitin 2018,2019 dhe 2020 shumen, t'ia paguaj shumën prej 1482.42€, në emër të kamatës së akumuluar për pagën e trembëdhjetë për këto tre vite nga rënia në vonesë e secilës page veç e veç e deri me datën 24.10.2022 në shumën prej 334.98€, në emër të kontributit pensional në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës për pagën trembëdhjetë për këto tre vite shumën prej 165.60€, dhe në emër të tatimit të mbajtur në birim në Administratën Tatimore të Kosovës për pagën trembëdhjetë për këto tre vite shumën prej 90.69€; për paditësin e tretë R. D., në emër pagës së trembëdhjetë për vitin 2018,2019 dhe 2020 shumen, t'ia paguaj shumën prej 1255.68€, në emër të kamatës së akumuluar për pagën e trembëdhjetë për këto tre vite nga rënia në vonesë e secilës page veç e veç e deri me datën 24.10.2022 në shumën prej 283.78€, në emër të kontributit pensional në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës për pagën trembëdhjetë për këto tre vite shumën prej 139.14€, dhe në emër të tatimit të mbajtur në birim në Administratën Tatimore të Kosovës për pagën trembëdhjetë për këto tre vite shumën prej 91.92€; për paditësen e katërt F. K., në emër pagës së trembëdhjetë për vitin 2018,2019 dhe 2020 shumen, t'ia paguaj shumën prej 1493.16€, në emër të kamatës së

akumuluar për pagën e trembëdhjetë për këto tre vite nga rënia në vonesë e secilës page veç e veç e deri me datën 24.10.2022 në shumën prej 337.44€, në emër të kontributit pensional në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës për pagën trembëdhjetë për këto tre vite shumën prej 166.86€, dhe në emër të tatimit të mbajtur në birim në Administratën Tatimore të Kosovës për pagën trembëdhjetë për këto tre vite shumën prej 91.92€; si dhe për paditësen e pestë M. M., në emër pagës së trembëdhjetë për vitin 2018,2019 dhe 2020 shumen, t'ia paguaj shumën prej 1384.08€, në emër të kamatës së akumuluar për pagën e trembëdhjetë për këto tre vite nga rënia në vonesë e secilës page veç e veç e deri me datën 24.10.2022 në shumën prej 312.79€, në emër të kontributit pensional në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës për pagën trembëdhjetë për këto tre vite shumën prej 154.08€, dhe në emër të tatimit të mbajtur në birim në Administratën Tatimore të Kosovës për pagën trembëdhjetë për këto tre vite shumën prej 79.77€.

Gjykata, përmes ekspertizës financiare të lartpërmendur, ka arritur të vërtetoj faktin se Komuna e Prishtinës ka pasur përgjatë viteve 2018, 2019 dhe 2020, tepricë (mbetje) të buxhetit, i cili ka qenë i ndarë për të paditurën.

Nga leximi i Raportit të Auditimit për Komunën e Prishtinës, për vitin financiar të përfunduar me datë 31.12.2018, gjykata ka vërtetuar se e paditura ka shpenzuar vetëm 71% të buxhetit final për vitin 2018.

Nga leximi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Prishtinës. për vitin 2019, gjykata ka vërtetuar se e paditura ka shpenzuar vetëm 71% të buxhetit final për vitin 2019.

Nga leximi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Prishtinës, për vitin 2020, gjykata ka vërtetuar se e paditura ka shpenzuar vetëm 61% të buxhetit final për vitin 2020.

Me nenin 4 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës parashihet se “Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe

punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj”. Ndërsa, në nenin 90 i këtij ligji parashihet se “1. Marrëveshja kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënëseve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin, edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: 2.1. në nivel të vendit, 2.2 nivel të degës; 2.3. nivel të ndërmarrjes. 3. Marrëveshja Kolektive mund të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet. 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive. 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj”.

Me nenin 4 paragrafi 1, pika 1. të Kontratës Kolektive Sektoriale, të datës 11.06.2018, tash e tutje referuar si “Kontrata Kolektive” parashihet që ”KKS-ja gjen zbatim në rregullimin e raporteve juridike për të gjithë të punësuarit nëpër institucione shëndetësore, duke përfshirë tri nivelet e sistemit shëndetësor, atë parësor, dytësor dhe tretësor”, dhe paragrafi 2 “Fushë zbatimi i KKS-së ushtron efekt tek punëtorët shëndetësor dhe administrativ në institucione shëndetësore”.

Gjithashtu, me nenin 17 paragrafi 1 i Kontratës Kolektive Sektoriale parashihet se “[p]unëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, [...] për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij”, për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy pagave mujore të tij” si dhe për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri pagave mujore të tij”. Kurse, paragrafi 4 i po të njëjtit nen përcakton se “Punëdhënësi i fundit është ai që i paguan shpërblimet jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”.

Ndërsa, me nenin 17 paragrafi 2 i Kontratës Kolektive Sektoriale parashihet se

“Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësve buxhetore të punëdhënësit”.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura. Kjo wshtw vërtetuar edhe nga kontratat me kohe tw pacaktuar tw lidhura nw mes paditësve dhe tw paditurës. Megjithatë, kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadisë, se a kanë bazë ligjore për të kërkuar paditësit shumën e kërkuar nga e paditura apo jo, në emër të shpërblimit jubilar si dhe në emër të pagës së trembëdhjetë.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia e paditësve duhet të aprovohet. Kjo ngase në bazë të provave të administruara është vërtetuar se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në Qendrën Kryesore e Mjekësisë Familjare me seli në Prishtinë, që gjë dëshmohet nga kontrata e punës për secilën paditës veç e veç. Në rastin konkret, gjykata gjatë vendosjes lidhur me këtë çështje vlerësoi Nenin 4, paragrafët 1 dhe 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale, përmbajtja e të cilëve u paraqit më lart.

Gjykata ka aprovuar lartësinë e shumave të kërkuara nga palët paditëse, si dhe duke u mbështetur në ekspertizën financiare, të hartuar nga eksperti financiar Sh. S. Këtë ekspertizë, gjykata e vlerësoi si të hartuar në përputhje me rregullat e shkencës dhe profesionit, si dhe në përputhje të plotë me provat e dorëzuara e të administruara nga gjykata në këtë çështje kontestimore. Eksperti financiar, po ashtu ka qenë prezent në seancën gjyqësore, e të cilën ka dhënë sqarimet e nevojshme për ekspertizën e hartuar, si dhe i është përgjigjur pyetjeve të gjykatës dhe palës paditëse. Pala e paditur, në asnjë rast nuk e ka kundërshtuar ekspertizën financiare, e as nuk ka pasur ndonjë propozim për plotësimin e së njëjtës, ose për hartim të ekspertizës së re financiare.

Lidhur me kërkesën për kompensimin e pagës së trembëdhjetë, gjykata e aprovoi këtë kërkesë të paditëseve dhe atë bazuar në nenin 17, paragrafin 2 të Kontratës Kolektive

Sektoriale ku shprehimisht parashihet që “Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësve buxhetore të punëdhënësit”. Meqenëse nga ekspertiza financiare e hartuar nga eksperti financiar Sh. S., si dhe duke u bazuar në raportet e Auditimit për vitet 2018, 2019 dhe 2020 për Komunën e Prishtinës, është përcaktuar se e paditura ka mundësi buxhetore të paguaj pagat e trembëdhjeta, për shkak të tepricës (mbetjes) së buxhetit të planifikuar, gjykata ua njohu pagat e trembëdhjeta paditësve, në shumat të cilat janë përcaktuar nga ekspertiza financiare dhe aq sa janë kërkuar nga vet paditësit përkatësisht përfshin vitet 2018, 2019 dhe 2020, periudhë gjatë së cilës ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale.

Në lidhje me kamatën ligjore që duhet ta paguaj e paditura për shumën e aprovuar (pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi), gjykata ka vlerësuar si në vijim: duke marrë për bazë ekspertizën financiare të hartuar nga eksperti financiar, gjykata ka vendosur që për secilën kërkesë të paditësve t’ua njoh kamatën në lartësi prej 8%, nga dita e arritjes së secilës kërkesë veç e veç, përkatësisht për kërkesën pagës së trembëdhjetë, ashtu siç janë përcaktuar në vlerat përkatëse në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, e të cilat përfshijnë periudhën nga hyrja në fuqi e Kontratës Kolektive Sektoriale (datë: 12.06.2018) e deri në hartimin e ekspertizës financiare (datë: 24.10.2022). Kurse, në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, gjykata ka obliguar të paditurën që paditësve t’ua paguaj kamatën, e cila rrjedhë për pagesë nga data, 25.10.2022 e deri në pagesën definitive, kjo bazuar në nenin 382 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Mënyra e vendosjes së kamatës në këtë çështje juridike, në këtë formë, gjen mbështetje në Mendimin Juridik për kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës, me numër 265/2020, të datës 02.12.2020, i cili parasheh se kamata të çështjet që kanë të bëjnë me paga dhe kërkesa të tjera nga marrëdhënia e punës duhet të llogaritet nga arritja e secilës kërkesë veç e veç, ndërsa kamata vetëm ndaj borxhit kryesor të llogaritet nga data e përfundimit të ekspertizës.

Sa i përket pretendimit të përfaqësueses të paditurës se kërkesëpadia e paditëseve sa i përket kompensimit të pagës së trembëdhjetë duhet të refuzohet, për faktin se bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale, përkatësisht nenin 17 paragrafi 2 i saj, i cili përcakton se punëmarrësi mund të kompensoj pagën e trembëdhjetë për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit, e që në rastin konkret kjo dispozitë ka fjalën “mund”, e cila nuk ka karakter obligativ për punëdhënësin, dhe se ky kompensim është në vullnetin e punëdhënësit, këto pretendime për gjykatën janë të pa bazuara. Kjo për faktin se nga marrja e provës përmes ekspertizës financiare është vërtetuar se e paditura ka mundësi buxhetore që të kompensoj pagën e trembëdhjetë për punëtorët e saj, pasi që ka tepriçë të buxhetit për vitet 2018, 2019 dhe 2020. Gjykata do të vendoste ndryshe në qoftë se do të konstatohej nga ekspertiza se e paditura nuk ka mundësi buxhetore për të kompensuar paditësve pagën e trembëdhjetë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë konform nenit 449 të LPK-së si dhe duke u bazuar Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës, ku është obliguar pala e paditur që paditëses t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 4,980.00 €, dhe atë si në vijim: në emër të përpilimit të padisë shumë prej 312 €, në emër të përfaqësimit për dy seanca gjyqësore shumë prej 881.20 € (405.60 € x 2 seanca gjyqësore), në emër të ekspertizës financiare shumë prej 20.00 €, si dhe në emër të pagesës së taksës gjyqësore shumë prej 300.00 €. Të gjitha shumat e llogaritura janë në vlerën e përcaktuar në bazë të Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës, duke marrë për bazë edhe numrin e personave të cilët i ka përfaqësuar përfaqësuesi i autorizuar, anëtar i licencuar pranë Odës së Avokatëve të Kosovës. Gjykata, ka refuzuar kërkesën e paditësve për pagimin e shpenzimeve të procedurës, dhe atë në emër të hartimit të parashtresës me të cilën është precizuar kërkesëpadia në shumë prej 312 €, kjo pasi që këtij veprimi procedural nuk i ka dhënë shkas pala e paditur.

Nga të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.2478/2021, më datë 17.01.2023

Përparim Zeka

Gjyqtar

UDHËZIMI MBI TË DREJTËN E ANKESËS:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimi të së njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palën kundërshtare.